



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 192/15 Prot.

Tiranë më, 26.06. 2024

Lënda: Mbi procedurat e lëvizjeve paralele sipas udhëzimit nr. 08, datë 03.05.2024, “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar

DREJTORIVE RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

ZYRAVE VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Bazuar në Ligjin Nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 08, datë 03.05.2024, “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 10, datë 25.05.2024, Udhëzimin nr.14 datë 10.07.2023, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar., shkresën e MAS nr. 363/2 prot., datë 20.06.2024 “Mbi procedurën e lëvizjes paralele të mësuesve për vitin shkollor 2024-2025.

Në vijim drejtoritë rajonale, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar publik duhet të zbatojnë detyrimet e përcaktuara si më poshtë:

1. Afati i dorëzimit të dosjeve nga mësuesit që dëshirojnë të kryejë lëvizje paralele para fillimit të vitit mësimor 2024-2025 është nga data **1 korrik 2024 - 15 Korrik 2024**.
2. Mësuesi i punësuar me kontratë pune me afat të pacaktuar, që dëshiron të kryejë lëvizje paralele brenda ZVAP-së ku është i punësuar, ngarkon në adresën e emailit përkatës dokumentacionin sipas shtojcës 2 të udhëzimit nr.10.
3. Procedura e vlerësimit të dosjeve të mësuesve që mbeten pa ngarkesë mësimore, për vitin 2024-2025 në nivel shkolle të kryhet brenda datës 15.07.2024, duke u mbështetur në kriteret e shtojcës 2 të Udhëzimit nr. 08, datë 03.05.2024, “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar.
4. Drejtuesi i institucionit arsimor, brenda datës 15.07.2023, përcjell me shkresë zyrtare në ZVAP-in përkatës shtojcën 2, të plotësuar për mësuesin/it që në vlerësimin e dosjeve të kryer nga KVD-ja e shkollës, ka/kanë dalë me më pak pikë dhe ka/kanë ngelur pa ngarkesë mësimore .
5. ZVAP dërgon në DRAP-in përkatës, brenda datës 20.07.2024, me shkresë zyrtare listën e mësuesve që në vlerësimin e dosjeve të kryer nga KVD-ja e shkollës, ka/kanë dalë me më pak pikë dhe ka/kanë ngelur pa ngarkesë mësimore .

6. KVD-ja e DRAP-së, brenda datës 22 korrik, vlerëson dosjet e kandidatëve që kanë aplikuar për lëvizje paralele me dëshirë. Rezultatet e vlerësimit paraprak publikohen në faqen e DRAP-së dhe të ZVAP-së, si dhe i dërgohen me email çdo aplikanti.
7. Kandidati që ka aplikuar për lëvizje paralele brenda të njëjtës ZVAP, ka të drejtë të paraqesë ankesë në DRAP për rezultatin paraprak, brenda 3 (tri) ditëve nga marrja e njoftimit të rezultatit., nga data 23.07.2024-25.07.2024
8. KVD-ja e DRAP-së, brenda 3 (tri) ditëve pune, shqyrton ankesat dhe i njofton me *email* çdo kandidati rezultatin përfundimtar të vlerësimit të dosjes për lëvizje paralele nga data 26.07.2024-30.07.2024
9. KVD-ja e DRAP-së rendit për çdo ZVAP sipas profileve, mësuesit që kanë ngelur pa ngarkesë mësimore dhe mësuesit që kanë bërë kërkesë për lëvizje paralele në të njëjtën ZVAP. Këto lista i publikon në faqen zyrtare të DRAP-së, si dhe i dërgon për publikim në ZVAP-në përkatëse brenda datës 31.07.2024.
10. Vendet e lira të punës që janë krijuar brenda një ZVAP-je u ofrohen për punësim mësuesve të cilët kanë ngelur pa ngarkesë mësimore (lëvizje paralele e detyruar) brenda datës 02 shtator 2024.
11. Vendet e lira të punës të mbetura pas lëvizjes paralele me detyrim, brenda një ZVAP-je u ofrohen për punësim mësuesve të cilët kanë aplikuar për lëvizje paralele me dëshirë, sipas profileve dhe renditjes, brenda datës 04 shtator 2024.
12. Në rast se në ZVAP-të e tjera të DRAP-së rezulton se pas njoftimit për punësim, ka vende të lira pune, atëherë këto vende u ofrohen kandidatëve të papunësuar të të gjitha ZVAP-ve në juridiksion, të cilët kanë ngelur pa ngarkesë mësimore, sipas profileve, duke filluar me kandidatin me më shumë pikë. brenda datës 04 shtator 2024.
13. DRAP-i njofton AKAP-in me shkresë zyrtare në datën 5 shtator 2024, në lidhje me punësimet e kryera, e cila i heq nga lista e publikuar këto vende të lira pune.

Adresat e emailit ku do të bëhet aplikimi për lëvizje paralele me dëshirë janë:

DRAP Durrës: Levizjeparalele2024.drapdurrës@arsimi.gov.al

DRAP Fier: Levizjeparalele2024.drapfier@arsimi.gov.al

DRAP Korçë: Levizjeparalele2024.drapkorçe@arsimi.gov.al

DRAP Lezhë: Levizjeparalele2024.draplezhe@arsimi.gov.al

Faleminderit për bashkëpunimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Rezarta ALLI

